

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Data 16.03.2023

Ora 12:03

RENDI I DITËS

“Shqyrtimi i Kërkesave Ankimore nr. 32 dhe 33, objekti “shfuqizimi i vend. Nr. 172, dt.14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Subjekti Ankues Partia Demokratike”.

PJESËMARRJA:

- **1.KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- 2. Staf i KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. E. Mema, Z. I. Osmanaj
- PARTI POLITIKE:** PD (I. Sefa) (L. Nuraj, F. Nuri)
- Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Përshëndetje! E deklarojmë të hapur seancën e sotme për shqyrtimin në themel të kërkesave ankimore: nr. 32 dhe 33, të depozituara respektivisht: për kërkuesin Partia Demokratike, përfaqësuar nga zoti Indrit Sefa dhe për kërkuesin, po Partia Demokratike, përfaqësuar nga zoti Sali Berisha, me objekt: kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 172, datë 14.03.2023, me objekt ndryshimin e vendimit duke vendosur regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga dy kërkuesit, respektivisht si të sipërcituar. Sipas shortit relatori i kësaj çështjeje jam unë, Koli Bele. Para se të fillojmë shqyrtimin e kësaj çështjeje verifikojmë legjitimitimin procedural. Prezent është KAS-i, i përbërë nga 5

1

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

anëtarët, kemi prezent administratën e KQZ-së, përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm. Gjithashtu, verifikojmë prezencën e kërkuesve. Ju lutem, për rekord të identifikohen.

Z. Indrit Sefa: Indrit Sefa, prezent.

Z. Ledion Nuraj: Ledion Nuraj, prezent.

Z. Franci Nuri: Franci Nuri, prezent.

Z. K. Bele: Po, kredencialet tuaja janë të administruara gjatë procesit, kështu që vazhdojmë. Në këtë fazë, a kemi ndonjë kërkesë paraprake lidhur me trupën?

Z. Ledion Nuraj: Nga ana jonë, jo.

Z. Ledion Nuraj: Jo.

Z. K. Bele: Faleminderit! Ftojme sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së të na paraqesë shkurtimisht një përmbledhje të situatës ku jemi me procesin.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Më datën 14 mars, të vitit 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim kërkesën e Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në përfundim të këtij shqyrtimi administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me arsyetimin se zoti Sali Berisha nuk legjitimohet, nuk ka legjitimin aktiv në ngritjen e kësaj kërkesë, si edhe me arsyetimin se akti autorizues për

2

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

personin që ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e Partisë Demokratike, ashtu si edhe deklaratën e angazhimit solemn të kryetarit të Partisë Demokratike zotit Lulzim Basha, nuk përmbush kërkesat e nenit nr. 64 të Kodit Zgjedhor, ka vendosur mos regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj të vitit 2023. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Indrit Sefa, si edhe Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga zoti Sali Berisha, të cilët kanë edhe argumentet pse nuk janë dakord me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Çështja ka kaluar për shqyrtim dhe është tryezën tuaj. Faleminderit!

Z. K. Bele: Desha të ripërsëris edhe njëherë pyetjen, pak a shumë e dimë përgjigjen, por, gjithsesi, për rekord: A ka ndonjë vendim tjetër të Komisionerit lidhur me kërkesën e kërkuarit të përfaqësuar nga zoti Ledio Nuraj, pra kërkuarit Sali Berisha? A kemi ndonjë disponim të ri, pasi deri në ditën e djeshme kur është diskutuar kalimi në seancë, nuk kemi pasur ndonjë vendim për këtë kërkesë.

Z. Y. Merhaj: Jo, në dijeninë time, në protokollin e KQZ-së nuk ka ndonjë kërkesë të zotit Ledio Nuraj.

Z. K. Bele: Faleminderit! A keni pyetje? Po, zoti Sefa, sipas radhës.

Z. I. Sefa: Duke qenë se e kisha të pamundur të pyesja Komisionerin, dhe duke qenë se edhe sekretari i Përgjithshëm përfaqëson administratën dhe Komisionerin, kam disa pyetje që do të ishin në interes të shqyrtimit të kësaj ankese pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. K. Bele: Më falni, për procedurë, ju lutem, prezantoni kërkesën tuaj dhe pastaj ne do të vazhdojmë ta bëjmë interaktive dhe ju mund t'i bëni pyetje sekretarit.

Z. I. Sefa: Të prezantoj parashtrimin?

Z. K. Bele: Po. Të dëgjojmë të tria palët.

Z. I. Sefa: Unë i kam me shkrim, gjithashtu, do të flas në mënyrë të përmbledhur.

Z. K. Bele: Po mund të flisni në mënyrë të përmbledhur.

Z. I. Sefa: Po, i kam me shkrim, 13 faqe. Gjithashtu, do të kërkoj të depozitoj edhe disa prova në këtë shqyrtim gjyqësor. E para, është vendimi me numër 10, me numër 809 të regjistrimit datë 21.06.2021, me datë vendimi 13.07.2021 të gjyqtarit Juljan Haxhiu, i cili ka bërë edhe ndryshimet në regjistrin e Partisë Demokratike, në vitin 2021, dhe është në formën e kërkuar nga ligji. Gjithashtu, kemi edhe vendimin me nr. 2, datë regjistrimi 13.12.2021, dhe datë vendimi 18.03.2022, të gjyqtares Blerina Muço, ka bërë edhe ajo ndryshimet e fundit në regjistrin e partisë Demokratike që është kuvendi i 17 korrikut dhe statuti i ri. Gjithashtu, kemi vendimin, datë 22.04.2022, të gjyqtares Blerina Muça, me ankues nga nënkryetari i partisë, zoti Enkelejd Alibeaj, me disponim ankimi, në të cilin është vendosur pranimi i ankimit të palës ankuese: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga nënkryetari i saj zoti Enkelejd Alibeaj, ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, gjithashtu, kemi edhe një vërtetim nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me numër 2148 protokollit, datë 15.03.2023 në të cilin vërtetohet që ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022, në shqyrtimin që ka marrë

4

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur: mospranimin e ankimit ankues partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga komisioni i përkohshëm i rithemelimit, ushtruar ndaj vendimit nr.508, për disponimin e ankimit, si një vendim ndaj të cilit nuk bëhet ankim dhe prishjen e vendimin nr. 3 që është vendimi datës 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me një tjetër trup gjykues. A mund t'jua vë në dispozicion?

Z. K. Bele: Po.

Z. I. Sefa: Në lidhje me themelin, i gjithë arsyetimi i Komisionerit bazohet në dy pika. Pika e parë është që, sipas interpretimit literal, Komisioneri pretendon se nuk është mjaftueshëm i qartë, thotë, autorizimi për sa i përket datës specifike të zgjedhjes së 14 majit të vitit 2023. Komisioneri ngatërron në këtë pikë dy lloj autorizimesh: autorizimin e posaçëm dhe autorizimin e përgjithshëm. Në koncept autorizimi i posaçëm është një autorizim për një veprimi konkret, të specifikuar qartësisht se cili është veprimi, për të cilin i deleguari, ka kompetenca për të përfaqësuar delegesin. Në këtë rast kemi të bëjmë me një autorizim të përgjithshëm, i cili ka lënë tagra të përgjithshme në lidhje me të gjithë sferën e zgjedhjeve lokale dhe me të gjitha administrimin e zgjedhjeve lokale, do të thotë duke bërë ankimin në KAS dhe duke propozuar kandidatë e të gjitha me radhë. Ky është një autorizim, i cili i ka të gjitha tagrat e përmbledhur dhe është i përgjithshëm. Kjo nuk besoj dhe nuk duhej të kishte përberë arsye për Komisionerin, për të meta fillimisht, dhe për refuzuar regjistrimin e partisë politike në lidhje me çështjen e këtij autorizimi. Konkretisht autorizimi, i pretenduar nga Komisioneri, si jo mjaftueshëm i qartë, i referohet zgjedhjeve vendore të vitit 2023, sipas datës së dekretit që do të përcaktojë

5

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Presidenti i Republikës. Tani ai autorizim mund të vlejë për çfarëdolloj date që mund të ketë zgjedhje vendore në vitin 2023, që mund të kishte në janar deri në dhjetor. Çfarëdolloj date që do të vlerësonte Presidenti i Republikës, atëherë ai autorizim përsëri është i vlefshëm, sepse e ka tagrin e përcaktuar, thotë për zgjedhjet vendore të vitit 2023. Keni përmendur edhe nenin e Kushtetutës, i cili përcakton se zgjedhjet janë periodike, dhe, duke pasur në konsideratë, që zgjedhjet u zhvilluan në 30 qershor të vitit 2019, detyrimisht që ata duhej të ishin në vitin 2023, duke pasur parasysh peridiocitetin e zgjedhjeve lokale. Gjithashtu, fakt tjetër është edhe Kodi Zgjedhor, i cili përcakton që periudha e zgjedhjeve është nga 15 prilli deri më 15 maj që është periudha në të cilën përcaktohet se kur do të kryhen zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë. Përveç kësaj, autorizim i jep tagra përfaqësimi të përfaqësuarve, që jemi tre në atë autorizim, për të bërë të gjitha kërkesat, edhe për regjistrimin e partisë politike pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu, unë, si përfaqësues i Partisë Demokratike, jam edhe përfaqësues i përhershëm pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues i përhershëm i saj, dhe, në bazë të nenit 26 të Kodit Zgjedhor, unë kam të gjitha tagrat për të bërë kërkesa nga më të ndryshmet drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si rrjedhojë edhe kërkesa për regjistrimin e subjektit zgjedhor është një nga këto kërkesa, që mund t'i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndaj dhe kërkesa është firmosur nga unë dhe në bazë të autorizimit, por, edhe në bazë të ligjitimitit tim të mëparshëm në lidhje me përfaqësimin e përhershëm që kam ndaj subjektit zgjedhor, Partia Demokratike, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Po marr pikën e dytë se besoj se e kemi të ezauruar edhe në parashtrimet që kemi në ankim. Pika e dytë ka të bëjë me një deklaratë solemne, të cilën Komisioneri pretendon se është e domosdoshme, dhe është dokument detyrues për të bërë regjistrimin e partisë politike. Po të shikoni në përmbajtje të të gjithë deklaratës dhe të formulimit, që është miratuar nga Komisioni

6

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Rregullator, për deklaratën solemne, përcaktohet fare qartë që deklarata solemnet lëshohet në emër të partisë, në emër të subjektit. Është përgjegjësia që merr subjekti përsipër për të marrë përsipër detyrimet që përcakton nenin 64, shkronja “e” e Kodit Zgjedhor. Kjo deklaratë referon: Angazhimin solemn të partisë sonë se pjesëtarët e strukturave drejtuese dhe administrative të anëtarësisë, kandidatëve për deputetë, drejtues, anëtarë të organeve të qeverisjes vendore, deputetë, drejtues të organeve të qeverisjes vendore, të gjithë strukturave të tjera të angazhuara nga subjektet në këto zgjedhje funksionarë ish-funksionarë publikë do të refuzojnë të marrin pjesë në praktikën blerjes së votës marrjes së financimeve përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht në ato që vijnë nga aktivitete kriminale. Angazhohemi të zbatojmë rregullat për të gjithë anëtarësinë, administratën dhe ndjekësit tonë që të mos premtojnë, ofrojnë, japin para, mallra, shërbime ose dhe ose nxisin premtime punësimi ose trajtime të tjera të veçanta votuesve dhe ose të tjerëve, duke përfshirë familjen e votuesve apo komuniteteve të ndryshme, ose të veprojnë në mënyrë të tillë që synohet të ndikojë se arsyeshëm pritet të ndikojë në mënyrën si votuesit japin votën e tyre. Thënë më qartë: partia angazhohet, deklarata i referohet partisë dhe kryetari e firmosë si pasojë e detyrës që ai ka si drejtues i partisë politike. Po çfarë na mëson ligji për partitë politike? Ligji për partitë politike mund të ketë mënyra nga më të ndryshme organizimi, nuk ka pengesë ligji i partive politike. Partinë politike mund të përfaqësojë kryetari, një organ i përbërë nga disa anëtarë, mund të ketë marrëdhënie me të tretët, me institucionet publike, mund t’ia lënë kompetencat sekretarit sipas statutit e të gjitha me radhë. Kryetari mund të jetë vetëm një rol që merret me marrëdhëniet partiake dhe nuk ka kompetenca për t’u marrë me marrëdhënie me të tretët, por këto marrëdhënie me të tretët i bën sekretari. Sipas interpretimit që i bën Komisioneri, duhet që detyrimisht ta firmosë kryetari. Kjo bën ndesh edhe me vetë frymën e ligjit për partitë politike, sepse ligji për partitë politike

7

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

i lë kompetenca vetë organizmit të subjektit. Subjekti mund të organizohet në format nga më të ndryshme, mund të ketë një këshill regjence, mund të ketë një këshill të urtësh, mund të jetë një komision, nuk quhet kryetar, por quhet administrator i përgjithshëm, nuk ka kufizime ligji për partitë politike. Dhe Komisioneri i bën një interpretim të gabuar dispozitës, sepse e merr se kjo është një angazhim personal i kryetarit të partisë. Kryetari i partisë në asnjë moment nuk firmos si individ si një njeri natyror, por firmos si pasojë e funksionit të tij, si kryetar, partie. Kjo është fryma e deklaratës, është fryma tekstit të deklaratës së miratuar për të, është fryma e ligjit që të angazhohet partia që detyrimet t'i marrë partia. Çfarë dëgjuam nga relatimi i Komisionerit, që fatkeqësisht më bëri përshtypje, sepse e krahasoi me formulën e betimit të Presidentit. Të them të drejtën mbeta pak i habitur se nuk mund të krahasohen të dyja gjërat dhe janë totalisht në kundërshtim me atë çfarë thotë dhe formula e betimit të Presidentit. Së pari, betimi i Presidentit është kusht për marrjen e detyrës, është domosdoshmëri që Presidenti betohet për marrjen e detyrës. Po si është formula e betimit të Presidentit? Thotë: Beto hem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t'i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar. Presidenti mund të shtojë, edhe, thuhet aty: Zoti më ndihmoftë. Tani, Presidenti bën formulën e betimit, si akt individual, është një veprim individual, nuk thotë në asnjë rresht që Presidenca do të zbatojë Kushtetutën. Thotë, unë, si individ, si President i zgjedhur do të respektoj Kushtetutën, si qenie natyrore, jo si institucion jo në funksion të përfaqësimit të institucionit. Shembulli i marrë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është i metë dhe i çalë, sepse normalisht nuk mund të merret për analogji të dyja rastet. Gjithsesi ne, i nderuar relator, dhe të nderuar anëtarë, ne kemi bërë, gjithashtu, të qartë, nuk e di a ndodhen në fashikullin tuaj dhe shkresat që i kemi depozituar Komisionerit? Janë dy shkresa

8

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

që i kemi depozituar Komisionerit nuk e di a ndodhen në fashikullin tuaj? Më konkretisht është shkresa me numër Prot. 1602 datë 11. 03. 2023, është relatuar në...
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër por duhet që duhet t'i relatoj patjetër. Është shkresa në të cilën ne informojmë Komisionerin, në mënyrë të detajuar, që, nga ana e Partisë Demokratike, dokumentacioni është paraqitur i plotë dhe informojmë që zoti Basha ka dhënë dorëheqjen. Përveç faktit publik që e kemi përmendur disa herë, e informojmë dhe zyrtarisht që ka dhënë dorëheqjen. Në bazë të rregullave statutoire të vetë organizmit të partisë politike ne kemi vetë organizmin e brendshëm. Në bazë të ligjit për partitë politike nuk kemi detyrim të depozitojmë as në gjykatë, as në një institucion tjetër mënyrën e vetë organizmit tonë. Ne në gjykatë kemi depozituar statutin dhe të gjitha rregullat për zgjedhjen e kryetarit të ri. Për rregullimet e brendshme, brenda partisë ne kemi rregulla statutoire që i përcaktojmë vetë. Çfarë thotë ligji për partitë politike? Ligji për partitë politike thotë se partia duhet të depozitojë adresën vulën, stemën, emrin e kryetarit dhe emrin e partisë politike. Këto janë të depozituara, pastaj si rregullohet partia brenda, se kush janë anëtarët e kryesisë, kush janë anëtarët e këshillit kombëtar, cilët janë sekretariatet, asnjë dispozitë të ligjit, nuk e përcakton që këto janë të detyrueshme për t'u paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, për t'u pasqyruar në regjistrin e partive politike, sepse nuk ka një hapësirë të posaçme për t'u reflektuar këto. Ju e shikoni se edhe në vërtetimi që del nga gjykata është fare i thjeshtë dhe përcakton të dhënat kryesore, pra thuhet kur është regjistruar, kush është kryetar, emri i partisë dhe shkronjat nistore. Kaq ka vërtetimi që lëshon gjykata. Prandaj interpretimi i zgjeruar, që i bën Komisioneri, i cili ka dashur të hyjë edhe në terma logjikë, duke bërë interpretime personale, në mendimin tonë në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor. Përveç kësaj Komisioneri nuk ka asnjë kompetencë t'i hyjë shqyrtimit të brendshëm të partisë Demokratike. Ndaj dhe

9

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

të nderuar anëtarë të KAS-it për të mos t'u përmendur dhe konsideruar në mënyrë literale të gjitha, bëra një përmbledhje të shkurtër, por jam i hapur për të gjitha pyetjet që mund të keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe parashtrimet.

Z. K. Bele: Parashtrimet depozitohuni që ta kemi për rekord. Po përfaqësuesi i palës tjetër.

Z. L. Nuraj: Të nderuar anëtarë të KAS-it, kemi ardhur para jush sot në lidhje me ankimin e parashtruar mbi vendimin e Komisionerit, të marrë më datën 14.03 2023, vendim të cilin ne e gjejmë të pazbatueshëm në ligj, si në atë të partive politike dhe në Kodin Zgjedhor, dhe të gjithë paketës që normojnë jetën e partive politike. Mendoj se të gjithë setin e dokumentacionit, që ne kemi i kemi paraqitur Komisionerit, ju e dispononi dhe besoj jeni njohur me të. Pranë KQZ-së kemi paraqitur brenda afatit të përcaktuar të gjithë setin e dokumentacionit për regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë me kërkues kryetarin e saj, Sali Berisha, dhe kemi pritur të bëhej në seancën publike dëgjimore regjistrimi i kësaj partie. Në atë seancë është marrë në shqyrtim dokumentacioni jemi parashikuar si palë përfaqësuese nga Komisioneri. Jemi dëgjuar, kemi paraqitur të gjitha provat kemi bërë të gjitha relatimet e nevojshme, u jemi përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe gjatë relimit dhe gjatë vendimit kemi mbetur të shtangur pasi Komisioneri, në vetvete, në zbatim të rolit dhe funksionit, që i ka ngarkuar Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor ka kaluar dhe ka bërë rolin e një gjykate, do të thosha, dhe jo të mbante vijën dhe qëndrimin e tij në lidhje me regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga kryetari i saj, Sali Berisha. Pse e them këtë? Gjatë të gjithë debatit

10

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

dhe të gjithë arsyetimit të vendimit kemi parë që aty është arsyetuar dhe janë diskutuar dokumentacione, të cilat ne nuk i kemi paraqitur, disa dokumentacione të ardhura nga një burim tjetër, dhe mbi bazën e atyre dokumentacioneve që unë do të thosha, dhe do të kërkoja dhe vëmendjen tuaj gjatë shqyrtimit, që edhe ju ashtu si edhe Komisioneri keni të bëni me dokumentacione që nuk kanë vlerë ligjore apo nuk janë të kërkuara sipas formës së përcaktuara nga ligjet. Komisioneri aty ka diskutuar mbi disa vërtetime, ka diskutuar mbi disa autorizime dhe mbi këtë ka ngritur të gjithë logjikën e tij ku ka bërë përjashtimin e Partisë Demokratike duke mos marrë fare në konsideratë dokumentacionin e paraqitur në bazë të ligjit si nga ana formale si nga ana përmbajtjesore, nuk e ka marrë fare në shqyrtim dhe e ka anashkaluar për të bërë regjistrimin e partisë Demokratike. Ne jemi të bindur që po t'i referohej atij dokumentacioni që ne kemi dorëzuar dhe po të bënte pak edhe hetim, në rastin konkret, që Komisioneri e ka kompetencën të bëjë hetim mbi faktet dhe dokumentet që janë paraqitur, ne jemi të bindur që sot Partia Demokratike, me kërkues Sali Berishën, do të ishte regjistruar si parti politike apo si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore të 14 majit të vitit 2023. Kështu që duke anashkaluar një dokumentacion të saktë dhe të plotë, të ardhur si burim dhe me legjitimitet nga anëtarësia se, në fund të fundit, partitë politike, përveçse kushteve që përcaktojnë ligjin, kushti themelor që duhet të kenë është ai i anëtarësisë, dhe është anëtarësia që vendos për formimin e një partie politike, për krijimin e organeve dhe mandatimin e organeve drejtuese të saj, si dhe për përzgjedhjen e kryetarit të saj, të cilat ne të gjitha këto i përmbushnin dhe ia kemi dërguar Komisionerit për vendim. Pak a shumë, përpara Komisionerit kemi parashtruar, ashtu siç do të doja, dhe jam i detyruar, ndoshta duke shkelur pak edhe ekonominë e kohës, të nderuar, pasi dhe ju si organ jeni kuazi gjykatë dhe detyrohem që t'ua parashtroj edhe juve, pavarësisht se i parashtrova atje dhe nuk u mor asgjë parasysht, Partia Demokratike e Shqipërisë,

11

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

të nderuar, është formuar në dhjetor të vitit 90, aktet të cilat janë administruar në kohën përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë. Është parti politike me anëtarësi të gjerë, është partia politike më e madhe e opozitës aktualisht, është një parti politike që ka funksionuar prej 32 vjetësh, sipas të gjithë normave që normojnë jetën e një partie politike. Vendimet e fundit, në dijeninë tonë, janë të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku mbahet regjistri i partisë politike të Shqipërisë. Nga regjistrimi i fundit deri më sot, që ne po flasim, kanë ndodhur disa zhvillime në Partinë Demokratike, zhvillime të cilat janë të njohura botërisht dhe publikisht nga i gjithë opinioni si brenda ashtu dhe jashtë, ashtu siç jeni dhe ju të njohur si qytetarë të Republikës me zhvillimet që kanë ndodhur brenda Partisë Demokratike, zhvillime të cilat janë paraqitur në Rrethin Gjyqësor Tiranë dhe janë zhvillime brenda kuadrit ligjor dhe janë të regjistrueshme, që do të thotë janë akorde të regjistrueshme, por ende nuk kemi një formalizim të tyre për shkak të proceseve gjyqësore që janë krijuar. Rakordet ligjore të fundit, që janë të regjistrueshme, janë ato rekorde ku janë marrë me votim të drejtpërdrejtë nga anëtarësia e përfaqësuar nga delegatët e Partisë Demokratike në kuvendin e 11 dhjetorit të vitit 2021, nga ata kandidatë të cilët kanë marrë edhe vendimet në kuvendin e 17 korrikut të vitit 2021. Këtë doja ta sqaroja për ju, ju lutem, pasi nuk bëni jetë partiake siç bëjmë ne. Doja të sillja në vëmendjen tuaj, që të jeni sa më të qartë, pasi vendimet e fundit të 17 korrikut të vitit 2021 janë marrë nëpërmjet votës së delegatëve dhe mandati i delegatëve të korrikut do të vazhdonte deri në kuvendin pasardhës apo që do të mblidhej në lidhje me Partinë Demokratike. Mandati është i vazhdueshëm, mandati që delegatët e marrin nga anëtarësia, dhe është në fuqi deri në kuvendin e ardhshëm të programuar. Në bazë të statutit të miratuar në kuvendet e mëparshme dhe në këtë kuvend dhe që ka qenë i regjistruar dhe në fuqi në Gjykatën e Tiranës, ka qenë e drejtë prekluzive e kandidatëve, që mund të mblidhnin kuvendin, që do të thotë një kuvend i

12

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

vetëmbledhur me ¼-n e kandidatëve, që do të thotë, se mbledhja e 11 dhjetorit, (thjesht po ju a them që të jeni të qartë, pasi mund t'ju duhet të bëni edhe hetim dhe të merrni vendim mbi faktet e njohura botërisht), vendimi i mbledhjes së kuvendit të 11 dhjetorit, është një vendim i ligjshëm, që ka ardhur nga ¼-ta e delegatëve, që do ta quajmë vetëmbledhje të Kuvendit, për të rregulluar ato problematika që ishin shfaqur në Partinë Demokratike brenda disa muajve në lidhje me zhvillimet që ndodhen. Ai kuvend prodhoi organe të reja të qeverisjes së Partisë Demokratike me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Ai kuvend mori disa vendime në lidhje me jetën dhe me funksionimin e Partisë Demokratike, në lidhje me simbolin, logon, vulën dhe në mënyrë unanime, në mënyrë të plotë, ka bërë shkarkimin e kryetarit aktual, që ishte zoti Lulzim Basha. Ndër të tjera, po ky vendim kaloi edhe referendum po nga anëtarësia me votë të drejtpërdrejtë në lidhje me miratimin e vetëm të kësaj pike. Kështu që të gjitha këto akte nga përfaqësuesit e Partisë Demokratike i janë parashtruar Gjykatës së Tiranës për të bërë verifikimin e dokumentacionit dhe për të bërë regjistrimin dhe pasqyrimin e tyre në regjistrin e partisë politike, Partia Demokratike, ndër të tjera ku ishin logoja, vula e re, institucionet e reja që ishin zgjedhur dhe kryetari i ri zgjedhur, i cili ishte Sali Berisha. Kështu që patëm një vendim mbas shqyrtimit të dokumentacionit, i cili është në gjyq, fakt që dhe ju e dini, se fatmirësisht të gjithë jeni juristë me eksperiencë. Pati një vendim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është ende dhe sot akoma në fuqi, pavarësisht se presupozohet për vendime të Gjykatës së Apelit, siç jemi ne dijani. Por vendimi i Gjykatës së Apelit, të nderuar, ende nuk ka marrë fuqi zbatuese dhe ende nuk e ka shfuqizuar këtë vendim, pasi është dhe drejta e ankimit, ku vetë vendimi thotë në pikën fundit, që brenda 5 ditëve nga zbardhja, i cili ende nuk është zbardhur, do të ankimohet në Gjykatën e Lartë për rekurs. Kështu që ky vendim është ende i zbatueshëm, vendim të cilin ne, të nderuar, ia kemi

13

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

paraqitur Komisionerit për shqyrtim dhe për ta marrë parasysh në lidhje me ndryshimet e fundit të Partisë Demokratike. Përfitoj këtu dhe nga relatimi i mëparshëm i përfaqësuesit Sefa, ku vetë përfaqësuesi Sefa e pranoi që Partia Demokratike ka bërë kuvendet e fundit, janë zgjedhur organet legjitime të saj, është zgjedhur edhe kryetari i ri (sapo e tha, besoj e dëgjuat, që është zgjedhur edhe kryetari i ri), këtu biem dakord që është zgjedhur Sali Berisha, kryetar i ri. Në kuadër të kësaj, pavarësisht se kemi edhe një dorëheqje publike të zotit Lulzim Basha, të cilën e kemi me zë më e figurë dhe dorëheqjen në tashmë e dimë që është një institucion që bëhet në mënyrë personale për të pranuar një verdikt, një situatë apo një rrethanë, që hyn në fuqi menjëherë. Të nderuar, do të doja të sillja në vëmendjen tuaj se të gjitha aktet në i kemi në përputhje me ligjin, me nenin 64, i kemi të plotësuar. Në zbatim të këtij neni, në zbatim të frymës të Kodit Zgjedhor, Komisioneri, në tërësinë e ligjit, po edhe në germën e tij, të zbatonte dhe të aplikonte nenin 139, të bënte një hetim apo që duhet të ishte i detyruar në vendimin e tij, ai duhet të merrte parasysh edhe faktet e njohura botërisht, sepse Komisioneri në këtë rast është ai organ monokratik, në rastin konkret, i cili mbi bazën e një dokumentacioni duhet të bëjë regjistrimin e subjektit zgjedhor dhe në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet pengesë me artifica apo me lojëra termash juridikë, për regjistrimin e një partie politike apo t'u mohojë të drejtën zgjedhësve, anëtarësisë së një partie politike apo zgjedhësve të heqin nga zgjedhjet apo nga lufta elektorale një alternativë ndryshe. Për mendimin tonë, Komisioneri, me veprimet apo mosveprimet e tij, e ka bërë, sepse po t'i referohej nenit 139, me fakte të njohura botërisht, të gjitha këto fakte që unë ia kam paraqitur në mënyrë shkresore, legale dhe të njohura botërisht nga opinioni dhe nga të gjitha institucionet, ai detyrimisht do të bënte regjistrimin e partisë politike, me kryetar Sali Berishën, si subjekt zgjedhor dhe nuk do të na mohonte të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje, të cilën e kemi sjellë për

14

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

riparim nga ky komision, në të cilin ne po ankohe mi. Ndër të tjera, do të doja të sillja në vëmendjen tuaj që edhe provat e dorëzuara përpara jush të mos pranohen dhe të mos pranohen në unanimitet, pasi kemi të bëjmë në disa prova, të cilat nuk marrin formë ligjore dhe nuk janë akte sipas ligjit. U soll këtu një vendim i Gjykatës së Apelit, i cili nuk ka marrë formën e prerë, kështu që vërtetimi nuk është ende legal, që mund të merret si provë. U soll këtu një autorizim i nënshkruar përpara një viti nga një kryetar i dorëhequr, pikërisht 2 ditë përpara ku përcaktonte se ç' do të ndodhte mbas 1 viti. Ai vërtetim, në pikëpamjen tonë, ashtu si dhe Komisioneri ndoshta e ka pranuar, nuk është në formatin e duhur, pasi edhe në bazë të së drejtës administrative dhe ligjeve që normojnë në lidhje me aktet zyrtare apo aktet që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, përcaktohet qartë që një vërtetim e ka vlerën deri në 3 muaj. Mbas 3 muajsh kudo që të vemi, në çdo institucion, nga do që ta marrim, pavarësisht se institucioni rezulton ende dhe ushtron aktivitetin, po e sjell për analogji, vërtetimi nuk pranohet nga askush dhe të kthehet mbrapsht e të thuhet: të lutem, merreni brenda 3 muajve të fundit. Kështu që, ky vërtetim në këtë kuptim ka humbur çdo sens ligjor, pavarësisht se nuk gjendet as me numër protokolli, as me ekstremitetet e tij. Do të thosha që mund të kemi dhe elemente të një dokumenti të falsifikuar, kështu që doja të skualifikohet si provë nga ana juaj dhe të mos shqyrtohet fare. Ndërkohë për sa i përket deklaratës së solemnitetit, që ju paraqit juve si provë, do të thosha që deklarata e solemnitetit, që përcakton Kodi Zgjedhor, është një kërkesë e ardhur si një sugjerim i organizmave që kanë 32 vite që monitorojnë zgjedhjet, japin dhe rekomandimet përkatëse për të pasur gjithmonë një proces zgjedhor sa më të saktë. Është futur në vitin 2017 edhe si nevojë dhe nuk është një përgjegjësi që kryetari i partisë e merr si të drejtë nga funksioni si kryetar partie, por është një përgjegjësi individuale, nuk është një e drejtë e cila mund të delegohet, por është përgjegjësi personale e kryetarit të partisë për të mbushur këtë

15

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

formular. Në qoftë se Ledio Nuraj do të jetë kryetar i partisë, është përgjegjësi personale e Ledio Nurajt dhe nuk mund të delegohet. Prandaj edhe ligji përcakton pjesën solemne. Këtë mund ta sjell në analogji me plotësimin e formularit në bazë të ligjit të dekriminalizimit, që bën një kandidat për deputet apo për kryetar bashkie, i cili e ka përgjegjësi personale dhe nuk është përgjegjësi që mund të transferohet tek të tretët dhe të nënshkruajnë të tretët në lidhje me dekriminalizimin e kandidatit. Në momentin që edhe kandidati nuk pranon apo harron ta nënshkruajë këtë skualifikohet si kandidat. Këtë e thotë ligji dhe për më tepër ka përgjegjësi penale në lidhje me mosdeklarimin në bazë të ligjit të dekriminalizimit. Kështu që edhe ky arsyetim, ju lutem, të mos pranohet nga ana juaj dhe të kthehet mbrapsht. Në lidhje me këto gjetje, duke i parë edhe deri diku apo duhet t'i shikoni deri diku ju, ne mendojmë që e drejta është në anën Partisë Demokratike dhe drita është në anën atyre që ne përfaqësojmë këtu si përfaqësues të mandatuar. Kjo e drejtë duhet të kthehet në vend dhe është në të drejtën e zgjedhësve që të përfaqësohen. Ne, të nderuar, këtu dua t'ju bëj me dije edhe juve, por edhe opinionit publik, nuk jemi përpara jush dhe po kërkojmë regjistrimin për fonde. Ne po kërkojmë regjistrimin si subjekt zgjedhor të përfaqësojmë anëtarësinë tonë, të përfaqësojmë zgjedhësit, të sjellim alternativën ndryshe, dhe që zgjedhësit shqiptarë të kenë mundësi që të votojnë dhe të funksionojë pluralizmi ashtu siç duhet. Kështu që të gjitha këto duhet të kihen parasysh nga ju. Dokumentacionin ne e kemi paraqitur, ju i keni, kemi paraqitur të gjithë setin e plotë të dokumentacionit, kështu që ne presim një vendimmarrje nga ana juaj, në zbatim të ligjit, në atë që ne kërkojmë, në regjistrimin e Partisë Demokratike me kryetar Sali Berishën. Faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit! Ka pyetje nga kolegët?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. F. Nuri: Po, i nderuar, ju falënderoj! Në vijim të asaj që kolegu Ledio Nuraj sqaroi përpara jush dhe relatoi përpara jush, shkurtimisht vetëm 2 elemente në lidhje me vendimin e Komisionerit. Atëherë, dua të tërheq vëmendjen e të gjithëve që në seancën e parë Komisioneri kapi 2 elemente ose 2 pika problematike në lidhje me regjistrimin e Partisë Demokratike. U kap më tepër me pjesën e legjitimitit, duke legjitimuar përfaqësuesin e zotit Basha, për faktin se në fletën e regjistrit të partive politike figuron ende emri i zotit Basha. Pra, *prima facie* duket sikur ka legjitimitet, në fakt, po të shohim thelbin dhe po t'i analizojmë gjërat më në brendësi dhe përfaqësuesi, zoti Sefa, sot e pa dhe e deklaroi që zoti Basha ka dhënë dorëheqjen. Pra, legjitimimi duhet parë dhe në thelb, për mendimin tim. Një element tjetër që Komisioneri e ngriti në seancën e parë, por çuditërisht në vendimin përfundimtar u duk sikur u anashkalua, përveç pjesës së angazhimit solemn, ishte pjesë e autorizimit dhe problemi i autorizimit, sipas vetë Komisionerit, ishte vetë formulimi, i cili ishte i paqartë. Nuk dua të kapem me datën, nuk dua të kapem as me numrin e protokollit, as me elemente të tjera formale, sikundër i relatoi kolegu im, po thjesht me ato që vet Komisioneri Celibashi tha në seancën e parë, por që çuditërisht kjo nuk u relatua më dhe nuk figuroi më në vendimin përfundimtar. Pra, elementi i autorizimit, problemi, është tek togfjalëshi i përdorur. Jo vetëm që gjuha e përdorur është në kohën e shkuar, pra në datën e caktuar nga Presidenti, gjuhë e përdorur një vit përpara, por autorizimi nuk është i qartë. Këtë gjë e ka thënë dhe Komisioneri Celibashi, sepse flet për zgjedhje të përgjithshme vendore dhe çuditërisht kjo gjë nuk është pasqyruar më në vendimin final. Pra, ne gjykojmë se problematikë, në këtë rast ka qenë edhe kjo pjesë, domethënë pjesa e autorizimit në gjuhën e përdorur, nuk është e qartë: ka qenë autorizim për zgjedhje të përgjithshme, për zgjedhje vendore? Pastaj nëse do të shohim pjesën e autorizimit në vetvete, të dhënë nga dikush që ka dhënë dorëheqjen, në gjykimin tonë, është zero fuqi juridike. Pra, si mund të

17

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

legjitimohet një palë sot që vjen paraqitet me një autorizim dhe thotë që kryetari ka dhënë dorëheqjen dhe është fakt i njohur botërisht? Pra, ose ka dhënë dorëheqjen, fakt i njohur botërisht, dhe autorizimi s'ka më vlerë ose kryetari hiqet në detyrë dhe... Nga ana tjetër, ne kemi plotësisht legjitimitet. *Prima facie* në ekstraktin e partive politike figuron akoma emri i ish-kryetarit, por në thelb ne kemi vendimin e Gjykatës të Shkallës së Parë. Kur them ne, flas si përfaqësues të Partisë Demokratike, të përfaqësuar nga kryetari, zoti Sali Berisha dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucion, në praktikën e tij dhe në vendimmarrjen e tij të mëparshme, citoj rastin e Bindjes Demokratike, ka regjistruar një subjekt politik thjesht dhe vetëm me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Në përfundim, për të mos marrë më tepër kohë, në gjykimin tim, duke mos marrë për bazë fakte të njohura botërisht, sikundër kjo përcaktohet shprehimisht edhe nga vetë Kodi Zgjedhor neni 139 pika 1, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shkelur Kodin Zgjedhor, procedurat, ligjin, duke mos pranuar regjistrimin e Partisë Demokratike, të përfaqësuar nga zoti Sali Berisha, si subjekt zgjedhor. Nisur nga sa më sipër, KAS-i duhet të ndryshojë vendimin, objekt ankimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke detyruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të bëjë regjistrimin e Partisë Demokratike, të përfaqësuar me kryetar Sali Berishën si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14 maj 2023. Kjo në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe jurisprudencën, po themi, të vetë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për rastet e mëparshme. Pra, përfundimisht kundërshtojmë vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 172, datë 14.3.2023 dhe kërkojmë ndryshimin e këtij vendimi duke vendosur regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, të përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Faleminderit!

18

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. K. Bele: Faleminderit!

Z. I. Sefa: Nuk kisha ndërmend të bëja debat, por..

Z. K. Bele: Zoti Sefa, do të jepet fjala. Jemi në fazën që ju dëgjuam me radhë dhe është faza që ne bëjmë pyetje nëse kemi. Ju keni vite që punoni në rrethana të ndryshme ose jeni pjesë e një procesi, nuk kanë rëndësi vitet, kështu që do t'ju lutesha, pavarësisht se ata t'u referuan pasi folën pas jush, ju do të keni përsëri të drejtë të flisni dhe mund të bëni sqarimet tuaja. Për procedurë unë do t'u drejtohem kolegëve nëse kanë pyetje në këtë fazë. Po, zoti Cefa.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Unë kam dy ose tri pyetje, në fakt, për zotin Sefa. Jemi të gjithë të qartë që sipas autorizimit që ju keni depozituar në KQZ për efekt të regjistrimit, zoti Lulzim Basha figuron ende kryetar i Partisë Demokratike në regjistrin gjyqësor. Unë doja të dija ose të kisha mundësi të kuptoja edhe unë faktin pse zoti Basha figuron ende kryetar i Partisë Demokratike, kur edhe ju vetë e pranoni, ashtu sikundër provohet edhe nga dokumentacioni që keni sjellë, ai ka të paktën 1 vit që ka dhënë dorëheqjen nga ky funksion. Pyetja konkrete është: statuti i Partisë Demokratike në fuqi në momentin kur zoti Basha ka dhënë dorëheqjen, a parashikonte zëvendësimin e tij nga strukturat e Partisë Demokratike dhe, në qoftë se keni mundësi të na e thoni, si e parashikonte këtë zëvendësim?

Z. I. Sefa: Patjetër, duke bërë pjesën e parë të pyetjes, po ju jap një përgjigje të shkurtër edhe për pjesën e afatit. Siç e dini, në ligjin për partitë politike nuk ka asnjë



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

dispozitë që mund t'i referohemi për depozitim e dorëheqjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, asnjë dispozitë ligjore. E dyta, ...

Z. E. Çefa: Mua më intereson statuti, ai është ligji i partisë.

Z. I. Sefa: Do ta referoj me germë statutin. E dyta, siç jeni në dijeni, pas bërjes së ankimit edhe me vendimin për disponim ankimi nr. 508, dosja origjinale e Partisë Demokratike që ndodhet në regjistrin e partive politike ndodhet në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Ligji për partitë politike citon shprehimisht: “Çdo kërkesë për ndryshimin në regjistrin e partive politike depozitohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.”. Fizikisht nuk kemi asnjë mundësi për t’iu drejtuar kësaj gjykate me një kërkesë. E treta, nuk është zgjedhur kryetari i ri i Partisë Demokratike. Kryetari i ri i Partisë Demokratike zgjidhet ...

Z. E. Çefa: Zoti Sefa, të lutem...

Z. I. Sefa: Do t’ju jap një përgjigje shumë të detajuar.

Z. E. Çefa: Dakord, do të vijmë edhe aty. Mendoj që do të ishte më e volitshme të sqaronim çfarë thotë statuti i partisë, statuti në atë moment e më pas mund të elaborojmë e diskutojmë çfarë ka ndodhur në fakt. Aty dua të dal edhe unë faktikisht, por do të kisha vlerësuar shumë renditjen sipas pyetjes edhe përgjigjen.

Z. I. Sefa: Te referojmë konkretisht statutin e Partisë Demokratike dhe fjala është për nenin 46, i cili ka edhe mënyrën sesi mund të bëhet. Po ta lexoj në mënyrë të detajuar. Pika 4: “Kryetari i partisë gjatë veprimtarisë së tij të përditshme u cakton

20

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

detyra në fusha të caktuara përgjegjësie nënkryetarëve të partisë. Në mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi, duke përfshirë edhe rastin e dorëheqjes nga detyra e kryetarit, sekretari i përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar, i cili komandon nënkryetarin, që do të drejtojë partinë deri në kthimin e kryetarit në detyrë me zgjedhjen e kryetarit të ri.” Pra, siç jeni në dijeni, Partia Demokratike ka pasur katër nënkryetarë: zonjën Duma, zotin Gjekmarkaj, zotin Alibeaj dhe zonjën Tabaku. Zonja Duma ka dhënë dorëheqjen në datën 9 mars, zoti Gjekmarkaj e ka dhënë dorëheqjen në datën 7 mars, zonja Jorida Tabaku në konsultim dhe në ngritjen që do i propozojë Këshillit Kombëtar emërimin, zgjedhja midis dy nënkryetarëve, zonja Tabaku refuzoi të marrë përsipër këtë detyrë. Sipas dispozitës, Këshilli Kombëtar komandon, nuk zgjedh, Këshilli Kombëtar është i detyruar që të zgjedhë patjetër njërin, kur ka më shumë se një alternativë. Në këtë rast nuk ka alternativë dhe Këshilli Kombëtar nuk ka kompetencë të mos komandojë nënkryetarin për të mos marrë detyrat e kryetarit. Për sa kohë nënkryetari është zgjedhur po nga Këshilli Kombëtar më përpara, me votë nga Këshilli Kombëtar, nuk ka më kuptim që i njëjti Këshill Kombëtar, kur nuk ka asnjë nënkryetar të disponueshëm, të mos komandojë nënkryetarin. Nuk mund të ketë vakum ligjor dhe drejtues në parti dhe në një subjekt politik. Është detyrim dhe kur është vetëm një nënkryetar i disponueshëm, i cili është zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, ai automatikisht merr edhe drejtimin e partisë, por jo si kryetar i zgjedhur, por si ushtrues i detyrës, i cili është deri në zgjedhjen e kryetarit të ri. Po vijmë edhe te pjesa e dytë e pyetjes që nuk regjistrohet nënkryetari sipas dispozitës së statutit për sa kohë që statuti i Partisë Demokratike thotë që kryetari i ri zgjidhet me parimin një anëtar, një votë. Në rast se ne i drejtohem gjykatës me këtë kërkesë, sipas dispozitës së nenit 46, gjykata ta refuzon kërkesën për sa kohë që kryetari i ri nuk është zgjedhur me parimin një anëtar, një votë.

21

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. E. Çefa: Nuk ishte pjesë e pyetjes a regjistrohet apo jo zëvendëskryetari i komanduar në detyrë. Pyetja ime në vijim është kjo: nocioni i komandimit është një nocion i përkohshëm juridik, që do të thotë që një person ushtron një funksion jo në pafundësi, është normale sidomos për jetën e partive politike zhvillohen zgjedhje dhe zgjidhet kryetari i ri sipas statutit. A është bërë nga Partia Demokratike zgjedhja apo a ka filluar procedura e zgjedhjes së kryetarit të ri sipas statutit? Këtu nuk flas për ushtruesin e detyrës së kryetarit, por po flas për kryetarin e ri, të cilin statuti dhe ligji e parashikojnë dhe e detyrojnë të regjistrohet në gjykatë.

Z. I. Sefa: Nuk kemi asnjë dispozitë statutore në të cilën përcaktohen afate se kur do të bëhen. Ai është një organizim i brendshëm i partisë dhe partia e vlerëson, ka kryesi, ka Këshill Kombëtar e të gjitha me radhë. Në qoftë se ky organ është i interesuar për vendimmarrje, unë nuk besoj se është koha dhe vendi për të marrë vendimmarrje të një subjekti politik, të cilat nuk janë të detyrueshme të regjistrohen në regjistrin e partive politike.

Z. E. Çefa: Zoti Sefa, arsyeja pse unë e bëj pyetjen është se duhet të kuptoj vlefshmërinë e këtij autorizimi, sepse këtu është i gjithë debati. Pra, ne sot po diskutojmë për një dokument të lëshuar nga një person, i cili ka mbi një vit që nuk është në detyrë. Për efekt të sqarimit të vlefshmërisë së këtij autorizimi unë kam nevojë të di dhe për këtë arsye po ju kërkoj përgjigje për këto pyetje, sepse praktikisht ne mund të kemi edhe në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të njëjtën situatë dhe do të na duhet të trajtojmë të njëjtën çështje me autorizime të Lulzim Bashës, kështu që për t'u sqaruar mirë e për të marrë një vendim do të kisha dashur të m'i sqaroni këto fakte: a ka apo jo ndonjë vendim të strukturave të Partisë Demokratike për zgjedhjen e kryetarit të ri sipas statutit? Po ose jo.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. I. Sefa: Statuti nuk përcakton afate. Ka një vendim politik për zgjedhjet brenda partisë do të zhvillohen duke filluar nga data 15 maj, në qoftë se jeni të interesuar për këtë.

Z. E. Çefa: Jo, çështja është se ka edhe një problem tjetër në këtë mes me emrin e kryetarit të partisë. Në qoftë se Komisioneri duhet të kishte pranuar kërkesën tuaj, në fletën e votimit do të regjistrohej Lulzim Basha si kryetar, apo jo? Që nuk është fakt i vërtetë. Dhe ky komision sot ka për detyrë të sqarojë të gjitha detajet që eventualisht mund të jenë pasoja të një vendimmarrje të KAS-it. Kjo është arsyeja pse unë pyes. E kuptova, për momentin nuk kam pyetje tjetër.

Z. I. Sefa: T'ju jap një përgjigje për vlefshmërinë e autorizimit?

Z. E. Çefa: Patjetër.

Z. I. Sefa: Pashë edhe një interpretim të zgjeruar të fatit të autorizimit dhe më bëri edhe habi në fakt se e krahasuan me certifikatë familjare ose personale që ka vlefshmëri 3-mujore...

Z. E. Çefa: Ju po bëni prapësime, sepse kjo nuk ishte pjesë e pyetjes sime.

Z. K. Bele: Ka të drejtën për të folur edhe për ato që folën ata.

Z. E. Çefa: Dakord prapësime për përfaqësuesit e tjerë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. L. Nuraj: Do të mbarojë seanca e pyetjeve apo do të kemi debat?

Z. K. Bele: Zoti Nuraj, folët shumë gjatë dhe nuk ju ndërpreme. Nëse do të shtoj diçka, le ta shtojë. Do t'ju lutem të jemi koncizë dhe ta orientojmë debatin drejt arsyes për të cilën ne jemi mbledhur dhe ka të bëjë me vendimin e Komisionerit. Sigurisht konsideratat dhe diskutimet mund të jenë të pafundme për një çështje që ne e pranojmë, është e një rëndësie dhe ndoshta është e pazakontë për këtë trup. Do t'ju lutesha të ishim koncizë e ta orientojmë debatin drejt asaj për të cilën jemi duke shqyrtuar sot, vendimin e Komisionerit. Faleminderit!

Z. I. Sefa: Ju kërkoj ndjesë edhe për ndërhyrjet, nuk do të përsëritet më. Në lidhje me vlefshmërinë e autorizimit, autorizimi krahasohet në të njëjtin format që krahasohen urdhrat dhe udhëzimet e ministrit. Ato kanë fuqi ligjore edhe pas mbarimit të mandatit të ministrit, por derisa shfuqizohen nga ministri i ri që vjen në detyrë. Përveç kësaj, kemi rast konkret, kemi rast të vërtetuar, kemi dy vendime gjykatash, kemi vendimin nr. 508 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka e pranuar autorizimin edhe pse kishte dhënë dorëheqjen zoti Basha datë 21 mars, rreth datës 22 prill, në mos gaboj, është vendimi i gjykatës. Të njëjtën gjë ka bërë edhe gjykata e juridiksionit të përgjithshëm, ka legjitimuar zotin Enkelejd Alibeaj me autorizim, i cili përsëri nuk ka numër protokolli. Kjo është e ezauruar nga ana ligjore dhe gjyqësore, vlefshmëria vazhdon deri në shfuqizimin nga pasardhësi.

Z. I. Rusmali: Zoti Sefa, ju keni paraqitur kërkesën për regjistrim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesa sigurisht është përpiluar nga ju në vullnetin tuaj të plotë të lirë, siç keni gjykuar që është e ligjshme, e keni hartuar kërkesën. Ju, gjithashtu, keni informuar KQZ-në se kryetari Basha ka dhënë dorëheqjen një vit më



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

parë dhe që nga ky moment funksionet i ka ushtruar kryetari i komanduar Alibeaj. Pse në kërkesën tuaj ju shkruani me dorën tuaj që kryetari i partisë është zoti Basha. Mund të na e shpjegoni këtë?

Z. I. Sefa: Sepse në funksion të ligjit dhe në funksion të përcaktimit që ka edhe formati i kryer nga Komisioni Rregullator përcaktohet emri i kryetarit që ndodhet në regjistrin e partive politike.

Z. I. Rusmali: Në ligj thuhet vetëm që deklarohet emri, domethënë ekstremitetet me adresë me të gjitha të kryetarit. Këtë thotë ligji. Deklarohet nga ana juaj.

Z. I. Sefa: Unë i jam referuar vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që është një vërtetim që është në themel të kërkesës për regjistrim sot juridikisht në regjistër si pasojë e pamundësisë për të bërë ndryshime, figuron i regjistruar zoti Lulzim Basha.


Z. I. Rusmali: Sot që ne flasim kush e ushtron detyrën e kryetarit të Partisë Demokratike? Zoti Basha, apo zoti Alibeaj?

Z. I. Sefa: Sot ushtruesi i detyrës së kryetarit të Partisë Demokratike është zoti Enkelejd Alibeaj, në zbatim të dispozitave të statutit të Partisë Demokratike.

Z. I. Rusmali: Në vazhdim të pyetjeve respektive që bëri kolegu im Cefa, ju shpjeguat procedurën e nenit 46. Ashtu si ka ndodhur ajo, pra duke u qëndruar besnik fakteve, pyetja ime është pak më tutje: statuti i partisë përcakton mekanizma ankimi ndaj akteve të organeve drejtuese, apo jo. A ka ndonjë anëtar partie, ndonjë pjesë të

25

*Zbardhi materialin audio
Mirgjinë LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*


forumeve ose ndonjë grupim brenda partisë Demokratike që të ketë shfrytëzuar mekanizmat e ankimit për t'u ankuar ndaj aktit të komandimit të zotit Alibeaj në detyrën e kryetarit?

Z. I. Sefa: Nuk ka asnjë ankim të paraqitur në komisionin e ankimeve pranë Partisë Demokratike.

Z. I. Rusmali: E dyta, në të njëjtën logjikë dhe për të njëjtin shkak, a ka ndonjë ankim në instancat gjyqësore për komandimin e zotit Alibeaj?

Z. I. Sefa: Nuk ka asnjë ankim në asnjë gjykatë të rrethit gjyqësor të Republikës së Shqipërisë në lidhje me këtë komandim.

Z. I. Rusmali: Dakord. Një pyetje tjetër, gjithnjë në kuadër të nenit 64. Neni 64 ka disa kërkesa, të cilat në thelb janë të gjitha deklarative. Ju jeni i lirë t'i mbushni si të doni. Duke shqyrtuar dokumentacionin e të dyja palëve, pala tjetër i referohet adresës së partisë në bulevardin "Zhan d'Ark" dhe pjesën vijuese. Pala juaj i referohet adresës së partisë në bulevardin "Zhan d'Ark". Një pjesë e kërkesave të nenit 64 nuk kanë lidhje me çështje të rëndësishme parimore, me ndarjen e rendit botëror, kanë lidhje me kërkesa praktike të KQZ-së. Adresa i duhet KQZ-së që të ketë mundësinë të komunikojë me vendin e saktë me ju, t'ju dërgojë monitoruesit, t'ju dërgojë audituesit e ku di unë me radhë...



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*


Z. I. Rusmali: Pyetja ime është, nëqoftëse audituesit e KQZ-së vinë në adresën e Bulevardit Zhan D'ark atje do ju gjejnë ju apo do të gjejnë palën tjetër?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Partia Demokratike është një dhe ka adresën zyrtare në regjistrin e partive politike dhe adresa është detyrim ligjor për tu pasqyruar sipas vërtetimit dhe regjistrit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky nuk është një problem, është një detaj teknik që besoj që KQZ-ja do të ketë të gjithë asistencën time si person i ngarkuar me komunikimin pranë KQZ-së, për të komunikuar të gjitha akte dhe për të bërë të gjitha proceduarat që i nevojiten KQZ-së.

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit, nëqoftëse mund të bëj disa pyetje për palën tjetër?

Z. K. Bele: Duke marrë shkas nga pyetja juaj, kam dashur të pyes Sekretarin e Përgjithshëm. Lidhur me qëndrimin tuaj mbasi neni 64 i ligjit siç me të drejtë e tha dhe kolegu Rusmali ka listuar disa kriterë. Vërtetimi që partia është në rrethin gjyqësor, emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë i cili është personi i autorizuar, emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën, ku kuptohet që këto kanë të bëjnë dhe më funksionalitetin. Vula gjithashtu është e rëndësishme, emri, mbiemri dhe adresa e financierit të partisë dhe emri, mbiemri dhe adresa e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ. Duke qenë se këto janë të shkruara në ligj, në vlerësim apo në kontroll të adresës nuk e di e bëni apo nuk e bëni kontrollin, a është adresa e saktë apo jo, por pavarësisht nga kjo, do të ishin këto kushte, pra adresa e pasaktë e financierit, të kryetarit apo e përfaqësuesit ligjor të partisë për të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

mos regjistruar apo regjistruar partinë, apo mosmbushja e kutisë së adresës si mendoni?

Z. Y. Merkaj: Nuk jemi përballur përballë këtij akti. Të gjitha kutitë janë mbushur. Me Partinë Demokratike kemi adresën Zhan D'ark dhe komunikojmë nëpërmjet postës elektronike dhe me adresën që...

Z. K. Bele: Nuk e kam për adresën konkrete të Partisë Demokratike, por doja të dija qëndrimin tuaj në lidhje me këto pika të vendosura në ligj, për të kuptuar si e shikon KQZ-ja këtë moment?

Z. Y. Merkaj: Ka dy momente.

Z. K. Bele: Pra, sigurisht këtu është edhe vërtetimi që provon ekzistencën e faktit juridik, pra që personi juridik ekziston, partia x, por janë edhe këto teknikalitete. A mendoni ju duke... *(nuk dëgjohet)* dhe pika e në fund, deklarata me shkrim e nënshkruar nga kryetari. A mendoni se kanë rëndësi para ligjit këto dhe a është kusht përmbushja e secilës nga këto që do e bënte të paregjistrueshme partinë? Qëndrimi juaj.

Z. Y. Merkaj: Po, për mendimin tim dhe mendimin e KQZ-së është kusht për skualifikim. Subjektet zgjedhore ose partitë politike që bëjnë kërkesë....zgjedhore, kanë paraqitur dokumentacionin. Nëqoftëse kanë pasaktësi ose të mëta ne jua kthejmë, i plotësojnë dhe nuk kemi patur raste që të mos i kenë plotësuar.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. K. Bele: Pra nëse kryetari nuk do të deklaronte adresë apo financieri i partisë nuk do e deklaronte, ju mendoni se ai në final nuk duhet të regjistrohej në zgjedhje, partia, cilado qoftë ajo.

Z. Y. Merhaj: Po, për ne kanë të gjitha të njëjtën rëndësi.

Z. K. Bele: Dakord, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Më bën përshtypje në shtjellimin tuaj zoti Nuraj. E kam dëgjuar disa herë edhe nga eksponentë të partisë. Ju thoni vendimi i shkallës së parë, ai i gjyqtarit Zhukri.


Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Po, ja ta cilësoj.

Z. I. Rusmali: Jo të lutem të mbaroj pyetjen njëherë. Ai vendim sot është në fuqi thoni ju.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Po.

Z. I. Rusmali: Vendimi i Gjykatës së Apelit që e ka prishur këtë vendim nuk është në fuqi. Tani unë kam nevojë të kuptoj sepse kjo më fut në kaos domethënë. Pse ai që është prishur është në fuqi dhe ai që ka prishur vendimin nuk është në fuqi. Duhet të na e shpjegoni më më detaj këtë edhe në gjuhë pak më popullore që ta kuptojmë dhe ne.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Atëherë i nderuar në konceptin tim, vendimi i Gjykatës së Apelit ende nuk është zbardhur, në dijeninë time. Por besoj se kështu është, ende nuk është zbardhur...

Z. I. Rusmali: Por është shpallur apo jo?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Është shpallur dhe në shpalljen që është bërë atë ditë, nuk i ka hyrë fare themelit të çështjes, thjesht e ka rikthyer për gjykim, me aq dijeni sa kam unë dhe ka lënë dhe afatin kohor për ankimim në Gjykatën e Lartë, që do të thotën të ushtrohet e drejta e ankimimit dhe rekursit dhe me vendimin e Gjykatës së Lartë merr zgjidhje përfundimtare në lidhje me çështjen e vendimit të Zhukrit. Prandaj dhe unë them që ai është ende një vendim në fuqi. Çfarë është, sepse ka qenë pa palë deri tani dhe është një vendim fakti, i cili ka marrë, ka parë ekzistojnë apo nuk ekzistojnë dokumentet për regjistrim në regjistrin që mbahet nga shkalla e parë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Ju lutem doja vetëm një saktësim të vogël, një plotësim në fakt në përgjigje, meqenëse kam qenë dhe unë në seancën e apelit dhe e kam ndjekur si çështje. Lidhur me pyetjen uaj, që ta kuptojë dhe publiku. Pak a shumë të gjithë janë të një mendimi që kur shprehet Gjykata e Apelit vendimi është i formës së prerë, por rasti vetëm kur vendimi nuk është i formës së prerë, sipas nenit 467 i Kodit të Procedurës Civile, në mos gaboj është rasti kur Gjykata e Apelit vendos prishjen për gjykim dhe në dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Apelit i bërë publik nëpërmjet deklaratës së mediave është lënë afati 5 ditor për rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu është një element tjetër që provon që vendimi i Apelit ishte një vendim i ndërmjetëm le të themi ndaj të cilit lejohet

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*


rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë. Pra, nuk është afati 30 ditor, afat i zakonshëm që lihet për recurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimeve të formës së prerë, por ishte një vendim i ndërmjetëm. Ai qenka i vetmi rast ku vendimi i Gjykatës së Apelit nuk është ende vendim i formës së prerë. Pra, sot që flasim vendimi i Apelit, përveç asaj që tha kolegu që është vendim i pazbardhur, i paargumentuar plotësisht dhe ne sot nuk i dimë shkaqet se pse është vendosur prishja e shkallës së parë. Sot ai vendim nuk është në fuqi. Presim zbardhjen e tij, do e rekursjmë dhe patjetër që praktikisht është i pezulluar vendimi, do pezullohet menjëherë gjithashtu sapo të zbardhet dhe do të presim vendimin e Gjykatës së Lartë. Vetëm pasi Gjykata e Lartë të shprehet brenda 30 ditëve, sipas Kodit të Procedurës Civile, atëherë ai vendim do të marrë formë të prerë dhe dosja do i kalojë shkallës së parë. Nëse gjithmonë nuk do të pranohet rekursi. Këto kisha.

Z. I. Rusmali: Mirë, na e shpjegoni dot çfarë kuptoni ju me fjalën që vendimi i shkallës së parë është në fuqi, çfarë do të thotë kjo?

Z. L. Braho: A e kuptoni ju se vendimi i shkallës së parë është i ekzekutueshëm sepse forma e prerë ka të bëjë me ekzekutimin.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Nuk është një vendim i cili ka vendosur për tu ekzekutuar diku. Vendimi është për pranim dokumentacioni dhe ky dokumentacion të administrohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Që do të thotë vendimi në vetvete ka pranuar dhe ka legalizuar dokumentacionin si të drejtë dhe në përputhje me parimet demokratike dhe të Kushtetutës dhe akteve të tjera në lidhje me vendimet që janë marrë brenda Partisë Demokratike dhe që janë të regjistrueshme. Besoj e dini shumë mirë se për çfarë vendimi po flasim. Nuk po flasim për një

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

vendim, për një të drejtë që duhet ekzekutuar kundrejt një të treti, as për marrjen e ndonjë godine, as për marrjen e ndnjë objekti etj., dakord? Flasim për një vërtetim fakti, për një vendim, vërtetim fakti, i cili ka vërtetuar një fakt. Është në përputhje apo nuk është në përputhje me ligjin.

Z. I. Rusmali: Dakord faleminderit për shpjegimet , vetëm mos i kërko kolegut të jetë menjëherë dakord me ju.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Jo.


Z. I. Rusmali: Se i the, je dakord apo jo? Këtë jo. Shpjegimet po. Ne dakord do të biem me njëri tjerin, jo me ju.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Si juristë, të biem dakord në lidhje me vendimn që po flasim. Doja të thoja të standartizojmë bisedën në lidhje me objektin që po flasim.

Z. I. Rusmali: Mirë, ajo në varësi të të njëjtës temë. Në aktet që keni marrë ju, që nga kuvendi i 11 dhjetorit, Ka ndonjë akt, i cili po të shkojmë sot në Gjykatën e Tiranës mund ta regjistrojmë sot? Është ndonjë akt që sot mund të regjistrohet? Në të gjithë aktet që nga Kuvendi i dhjetorit e mbrapa. Ka ndonjë që çohet sot për regjistrim? Që të kuptohet çështja e fuqisë dhe ekzekutimit pastaj.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Nga ana jonë janë çuar që të gjitha aktet dhe janë pranuar.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. I. Rusmali: Jo nuk po them nga ju. Në dijeninë tuaj Gjykata na e regjistron ndonjë akt sot, me gjendjen juridike që keni sot?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Pa marrë formë të prerë vendimi në shkallë të gjyqësorit, në situatën që ne sot jemi, nuk janë të regjistrueshme.

Z. I. Rusmali: Dakord faleminderit.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Por jo në lidhje me cilësinë e akteve që janë dorëzuar, në lidhje me procesin gjyqësor që po vazhdon.

Z. I. Rusmali: Dakord, e kuptova, është e qartë. Unë nuk kam pyetje të tjera.

Z. E. Lako: Kam unë një pyetje për palët dhe për administratën. Shkurtimisht pak a shumë u prek, por si e mendoni ju që një parti politike që në momentin që i vjen e drejta të regjistrohet si subjekt zgjedhor pranë KQZ-së, nuk ka kryetar ose kryetari ka pamundësi fiizke për të nënshkruar. A mundet dhe a duhet të regjisrohet si subjekt zgjedhor nga KQZ-ja?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Duhet të regjistrohet patjetër sepse një parti nuk është në vullnetin e një individi, por është në vullnetin e të gjitha strukturave drejtuese të anëtarësisë së saj dhe pjesëmarrja në zgjedhje është një e drejtë kushtetuese, e cila në hierarkinë e normave ka prioritet mbi të gjitha dispozitat e tjera ligjore e para dhe e dyta, pengesat e krijuara në rastin konkret, me falni se po i hyj rastit konkret nese ma lejoni. Pengesat e kryera në rastin konkret nga ana e Komisionerit, për një deklaratë solemne. E cila në fund të ditës është në emrin e

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*


subjektit zgjedhor dhe jo në emër individual të personit që drejton , por është në emër të subjektit zgjedhor. Është një pengesë artificiale që cënon rëndë një të drejtë kushtetuese për pjesëmarrjen në zgjedhje dhe në hierarkinë e normave, e drejta kushtetuese dhe liria themelore e njeriut për tu zgjedhur dhe për të zgjedhur nuk mund të cënohet nga një deklaratë solemne apo nga një interpretim mbi këtë dokument solemn nga ana e Komisionerit.

Z. E. Lako: Jo, pyetja ishte shkurtimisht nëse nuk ka kryetar për x arsye, objektive ose... kaq pa i hyr çështjes konkrete. A mundet dhe a duhet të regjistrohet si subjekt zgjedhor një parti që në momentin që i lind e drejta nuk ka kryetar për x arsye?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Mundet dhe duhet sepse kryetari është një organ i partisë, partia ka dhe organe të tjera, ka mënyra të tjera përfaqësimi, ka kryesi, ka sekretariat, ka nënkryetar e të gjitha më rradhë. Nuk mund të penalizohet një parti politike për mungesën e një organi që është dhe kryetari sepse mënyra e brendshme e organizimit të partisë është në diskrecionin e saj. Nuk mund të jetë kur nën diskrecionin një enti publik apo një enti shtetëror dhe vet listatori në hartimin e ligjit për partitë politike ka qenë shumë i qartë dhe shumë i matur në hartimin e dispozitave, duke i lënë hapësirë sa më shumë dhe hapësirë sa më të madhe vetrregullimit të brendshëm të partive politike dhe jo rregullimit më dispozita ligjore.

Z. E. Lako: Atëherë në vijim të kësaj juve mendoni se duhet regjistruar. Atëherë meqenëse duhet të regjistrohet cili do të jetë emri i kryetarit që do të vendoset në fletë votimi, meqenëse kërkohet nga ligji.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Sipas njoftimit që i kemi dërguar dhe KQZ-së...

Z. E. Lako: jo në rastin konkret, po flas në përgjithësi.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Organi i cilli rregullohet me statut, partinë dhe palën e tretë. Faleminderit!

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Në lidhje pikërisht me këtë çështje dhe duke dalë edhe tek regjistrimi në lidhje me fletën e votimit si një kusht i domosdoshëm në funksionimin e zgjedhjeve. Dhe nga pyetjet tuaja të nderuar, që i bëtë si zotit Sefa , ashtu edhe mua doli qartë, kjo edhe e artikuluar nga të dy, por edhe nga zoti Sefa që në lidhje me vërtetimin kur e pyetëm, u shpreh qartë që ky vërtetim ka dalë nga Gjykata e Tiranës për shkak të pamundësive, të reflektimit të ndryshimeve të fundit. U pranua që Partia Demokratike me kryetar nuk e ka më Lulëzim Bashën. Si nga ai dhe nga faktet që unë kam sjellë në lidhje me shkarkimin që i është bërë. U pranua po kështu edhe nga ai edhe nga mua se partia në vetvete është vullneti i zgjedhësve të saj dhe nuk mund të përjashtohen, pavarësisht se vendimi i gjykatës nuk është reflektuar për artificat e kërkuara, por vullneti i anëtarësisë është shprehur tashmë dhe po del dhe këtu publikisht shkarkimin e Bashës. Basha ka ikur. Në vendosjen dhe zgjedhjen e Kryetarit të ri po me atë adresë që ka patur, Zhan D'ark, e cila përsëri u pranua dhe doli nga pyetjet dhe në lidhje me fletën e votimit i nderuar, Partia Demokratike e ka kryetarin e saj dhe kryetari i saj është Sali Berisha. Ashtu siç ka ardhur dhe kërkesa, ashtu dhe siç po njihet dhe si fakt i njohur botërisht, siç po del edhe në këtë seancë. Fletët e votimit do të dalin me kryetar dhe Partia Dmokratarike nuk është pa kryetar. Në lidhje me pretendimet jo nënkryetari jo të tjera e të tjera që u thanë këtu nuk është asnjë akt i legjitimuar nga

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

anëtarësia, pasi të gjithë këta emra që pretendojnë se janë nënkryetarë, janë shkarkuar, siç u pranua edhe nga zoti Sefa nuk janë ende të regjistruar në regjistrin e partive politike që mbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me Partinë Demokratike. Kështu që duke qenë se trupa juaj është pothuajse gjykatë, pavarësisht se Komisioneri nuk i bëri këto veprime dhe që duhej ti reflektonte dhe duhej të merrte një vendimmarrje të drejtë që të regjistronte Partinë Demokratike më kryetar Sali Berishën se po e cilësoj gjithmonë, si subjekt zgjedhor, kërkoj nga ana juaj, për shkak edhe të gjithë këtyre zhvillimeve që po nddhin dhe dokumentacioni që ne kemi dorëuar dhe nga ato që po pranohen në këtë seancë edhe po dalin, në bazë të nenit 64, e përsëris edhe njëherë, duke qenë pothuajse gjykatë në lidhje me rregullimin dhe funksionimin e regjistrimit, apo partive, apo procesit zgjedhor, pikërisht për procesin zgjedhor dhe të kemi një proces zgjedhor sa më demokratik, do të kërkoja nga ju që të bëhej zëvendësimi procedural duke qenë se më fakte doli se zoti Basha nuk është më kryetar. Të bëjë zëvendësimin procedural të zëvendësimit të kryetarit të Partisë Demokratike nga zoti Lulzim Basha në zotin Sali Berisha dhe në vendimin tuaj të shpreheshit kështu siç po e kërkoj, domethënë për mendimin tim kjo është e drejta që po kërkoj dhe fleta e votimit dilte automatikisht me kryetar dhe këtu rregullohej i gjithë konflikti që ka ardhur përpara jush për tu zgjidhur.

Z. E. Lako: Shkurtimisht doja një përgjigje në rastin hipotetik kur nuk ka kryetar një parti politike, pa i hyrë rastit konkret dhe debatit se e dëgjuam. Kur nuk ka një kryetar...

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Ska pse të marrim rastin hipotetik, me gjithë respektin, sepse faktet janë që ka kryetar dhe unë atë po them.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. K. Bele: Më fal për të kontribuar pak zoti Lako nëse më lejon. Në vendimin në plotësim të pyetjes, sepse të njëjtën pyetje kisha dhe une dhe do ta shtroja një një formë të caktuar. Në vendimin e Komisionerit ndaj të cilit jeni ankuar është thënë tekstualisht, po e lexoj: “ Ajo mund të nënshkruhet edhe nga nënkryetari i partisë, por kjo mund të ndodhë vetëm në kushtet kur kryetari i partisë nuk është në detyrë. Është rasti kur ka dhënë dorëheqjen apo ka ndërruar jetë, apo nuk mund të ushtrojë funksionet e kryetarit për arsye objektive etj. Në këtë rast sot, do të duhet që organet e tjera të partisë Të dëpozitojnë në gjykatë njoftimin dhe kërkesat përkatëse, sipas të cilave kërkohet që funksionet e kryetarit ti marrë personi apo organi që sipas statutit të partisë e ka të drejtë”. Pra, Komisioneri ka mbajtur këtë qendrim që mundet të regjistrohet partia edhe kur nuk është kryetari në detyrë sepse mund të ketë ndërruar jetë apo ka dhënë dorëheqjen. Nga ana juridike, si ndërrimi i jetës , si dorëheqja janë të ngjashme për pasojën që prodhojnë. Mund të vdesësh juridikisht apo mund të vdesësh natyralisht dhe lë bosh karrigen e kryetarit siç me të drejtë thotë zoti Rusmali. Komisioneri ka thënë se mund të regjistrohet kur ndodhin këto por ka vendosur një kusht sipas tij. Ju çfarë qendrimi keni në situatën kur jep dorëheqjen një ditë para zgjedhjeve , pra në ditën e fundit të afatit kryetari jep dorëheqjen, apo dy ditë para zgjedhjeve nuk ka nënshkruar deklaratë apo siç thatë ju, ose ndodh një gjë tjetër kur kryetari i një partie x... A regjistrohet partia nëse kryetari bëhet i pamundur ta nënshkruajë një akt të caktuar, një apo dy ditë para, Kjo është pyetja.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Për mua jo. Për arsye se në kushtet ekskluzive që ka vënë Kodi Zgjedhor nëpërmjet nenit 64, pavarësisht se interpretimi që ka

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

bërë Komisioneri dhe ne këtë po godasim. Kemi të bëjmë me dorëheqjen përpara një viti. Kemi të bëjmë me një shkarkim të kryetarit dhe të gjithë organzmvave.

Z. K. Bele: Them i nje ditë para, dy ditë para.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Por nuk kam përse të eci me situatë hipotetike kur po përfaqësoj një parti me kryetar. Dhe po kërkoj dhe po godas pikërisht këtë që është shkruajtur mbi një situatë hipotetike. Kjo na cënon ne interesin tonë të ligjshëm. Ky interpretim dhe ky vendim i marrë mbi situata hipotetike. E gjithë pjesa e palës tjetër kërkuese është mbi një situatë hipotetike dhe jo mbi një situatë reale në lidhje me Partinë Demokratike. Ne këtë po mundohemi të shpjegojmë, por edhe sikur të kishte dy ditë, ke kërkesa që nuk mund të plotësohen nga nënkryetari për regjistrimin e këtij subjekti politik. Sepse janë disa kërkesa që nënshkruhen dhe duhet të jetë prania e tij dhe nuk kemi të bëjmë me raste fatale të vdekjes, por kemi të bëjmë me raste dorëheqje, që në momentin e dorëheqjes mbaron funksioni. Marrim dhe të presidentit dhe të gjithë...

Z. K. Bele: Pra nuk regjistrohet.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Nuk regjistrohet, dhe në lidhje me atë që ka shprehur Komisioneri për sa i përket kërkesës tjetër. Por unë jam këtu për të folur për kërkesën time.

Z. K. Bele: Unë kisha të njëjtën pyetje që kishte zoti Lako, por do të shtoja edhe një gjë tjetër, meqenëse ju e përfaqësoni Komisionerin. Pra, këtu citohet përveç situatës që referuam, në këtë rast do të duhej që organet e tjera të partisë të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

depozitojnë në gjykatë njoftimet për kërkesat përkatëse , sipas të cilave kërkohet që funksionet e kryetarit, ti marrë personi apo organi që sipas statutit ka të drejtë. Pra Komisioneri ka disponuar në këtë mënyrë. Ky arsyetim merr shkak nga ndonjë referim i caktuar ligjor, pra që kanë detyrimin të shkojnë në gjykatë për këtë dorëheqje, apo është një arsyetim logjik ne lidhje me rastin, në dijeninë tuaj nëse mund ti përgjigjeni kësaj pyetje dhe pyetjes së parë të zotit Lako a regjistrohet apo jo partia?

Z. Y. Merkaj: Siç e lexova ...(nuk dëgjohet) e Komisionit Qendror të zgjedhjeve me nenin 64 të Kodit Zgjedhor, por dhe nga praktika e administratës që nga hyrja në fuqi e këtij kodi e në vazhdim, nuk ka patur asnjë rast ku të jetë regjistruar një parti politike pa regjistruar emrin, pa dorëzuar emrin e kryetarit dhe të nënkryetarit.


Z. K. Bele: Pra, nëse nuk ka emrin e kryetarit...

Z. Y. Merkaj: Nëse nuk ka emrin, mbiemrin dhe adresën e Kryetarit nuk regjistrohet partia politike.

Z. K. Bele: Pra, nëse një ose dy ditë para kryetari jep dorëheqjen apo bëhet i pamundur për arsye natyrore, partia nuk regjistrohet pa kryetar thoni ju. Dakord, faleminderit.

Z. Y. Merkaj: Për pikën, për pyetjen e dytë, mendoj se është një arsyetim logjik i Komisionerit.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. K. Bele: Pra nuk ka një referim të caktuar ligjor. Mirë faleminderit. Nëse nuk kishit pyetje të tjera shtesë, i ftojme palët me dy fjalë të thonë përfundimisht çfarë kërkojnë. Zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Pranimin e ankimit, regjistrimin e Partisë Demokratike sipas kërkesës së depozituar nga unë si përfaqësues i Partisë Demokratike në KQZ dhe pranimin e ankimit siç e referova. Regjistrimin me emrin Partia Demokratike, me inicialet PD dhe me rregullimin që në emrin e kryetarit të zëvendësohet me emrin e ushtruesit të detyrës të zotit Enkelejd Alibeaj. Mbas njoftimeve të vazhdueshme që i kemi dërguar KQZ-së.


Z. E. Çefa: Ju kërkoj ndjesë... tani proceduralisht sapo u paraqit një kërkesë e re e cila nuk i është nënshtruar debatit. Kjo nuk ishte objekt i ankimit. Zëvendësimi i emrit procedural në fletën e votimit me ushtruesin e detyrës. Kështu që ne duhet ta diskutojmë pak këtë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Tani në ankim kam kundërshtuar vendimin e Komisionerit...

Z. E. Çefa: Qartë, sigurisht, por këtë kërkesë ja keni parashtuar edhe Komisionerit? Sepse unë është hera e parë që e dëgjoj, të paktën personalisht.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Komisioneri në kundërshtim nuk ka vënë në dispozicion asnjë projektvendim dhe si rrjedhimisht nuk kemi patur mundësinë të diskutojmë mbi projektvendimin e Komisionerit dhe është rast i veçantë, unikal që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka dhënë projektvendim vetëm për Partinë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Demokratike. Për çdo subjekt zgjedhor ka patur projektvendim, vetëm për Partinë Demokratike nuk ka patur projektvendim.

Z. E. Çefa: Zoti Sefa edhe njëherë. Nuk e di sesi procedon Komisioneri, unë di si procedon KAS-i. Ju lutem edhe njëherë pyetjes sime shumë thjesht po ose jo. E keni parashtruar këtë kërkesë që sapo bëtë këtu përpara Komisionerit dhe a keni marrë përgjigje për këtë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ja kemi referuar Komisionerit me 2 shkresa.

Z. E. Çefa: E keni ngritur si pretendim?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po, në seancë publike.

Z. E. Çefa: E keni depozituar shkresën si provë këtu?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Janë dy shkresat aty ku referohet se partia drejtohet nga zoti Enkelejd Alibeaj.

Z. E. Çefa: Atëherë, janë dy gjera të ndryshme të lutem. Të jemi korrekt. Që të referosh se nga kush drejtohet paria është diçka tjetër, që të pretendosh që personi i komanduar në drejtimin e partisë të futet si Kryetar i Partisë në fletën e votimit është diçka tjetër. Ju po kërkonit që KAS-i të marri attribute gjyqsore. Pra, atë që nuk e ka bërë gjykata duhet ta bëjë KAS-i. Këtë po thoni?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për efekt të pasqyrimin të ndryshimeve në fletën e votimit ne i kemi komunikuar Komisionerit...

Z. E. Çefa: I keni kërkuar apo komunikuar? Të lutem më sqaro.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Komunikuar që partia drejtohet nga zoti Enkelejd Alibeaj.

Z. E. Çefa: Qartë, faleminderit! nuk kam pyetje të tjera.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Atëherë, përfundimisht do të kërkoja të pranohej ankimi i paraqitur nga Partia Demokratike me përfaqësues kryetarin Sali Berisha. Të bëhet regjistrimi i saj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dt. 14 Maj 2023. Mbi ato argumenta që unë parashtrova ndaj jush duke u zbatuar ligji përpikmërisht, duke u zbatuar edhe praktika e KQZ-së që ka mbajtur në raste të ngjashme, kur ka regjistruar brenda 24 orëshit me vendim gjykate dhe jo me vërtetim, pasi në pamundësi për tu përdorur vërtetimet e gjykatave ashtu siç doli dhe upranua këtu, që nuk janë reflektuar ndryshimet e fundit që kanë ndodhur në Partinë Demokratike. Të merret i mirëqënë ai dokumentacion që kemi sjellë, të vendoset mbi fakte publike tashmë të ditura dhe të dali dhe të bëhet edhe zëvendësimi procedural po nga ana juaj pasi jeni pothuajse gjykatë, në lidhje me fletën e votimit që është kompetencë e KAS-it, domethënë është në fushën e gjykimit të KAS-it. Në pamundësi të këtyre dokumentacioneve të sjella nga të dyja dy palët, të bëhet zëvendësimi procedural i zotit Lulëzim Basha si kryetar i larguar nga Partia Demokratike, e pranuar edhe nga përfaqësuesit ankues të tjerë me kryetarin aktual të zgjedhur drejtperdrejt nga anëtarësia, ashtu sic e kërkon edhe

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

ligji për partitë politike me Zotin Sali Berisha për në fletën e votimit. Përfundimisht kërkojmë regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor dhe rrëzimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sa i përket pjesës në lidhje me partinë që unë përfaqësoj, faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit, zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Ne kërkojmë rrëzimin e kërkesave ankimore të paraqitura nga Partia Demokratike me përfaqësues Indrit Sefën, dhe rrëzimin e kërkesës ankimore të paraqitur nga Partia Demokratike me kryetar Sali Berishën. Lënien në fuqi të vendimit nr. 170 të Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve si një vendim i cili është mbështetur në ligj dhe i cili i ka dhënë përgjigje shteruese të gjitha kërkesave, pretendimeve të kërkuarve gjatë shqyrtimit administrativ, faleminderit.

Z. K. Bele: Atëherë KAS po tërhiqet për vendim. Ne po tentojmë të lëmë një orar të arsyeshëm, pra po themi për një orë, në rast se do të kemi arsye për ta shtyrë është e mirëkuptueshme. Nuk duam që t'ju mbajmë gjatë por po lëmë në parim orën 14:30, besoj kjo është e pranueshme edhe për ju. Atëherë mblidhemi në orën 14:30, faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 14:53

Z. K. Bele: Na falni, u vonuam pak nga ora e caktuar. Në përfundim të shqyrtimit, KAS bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 10019 dt. 29 dhjetor, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, në emër të KQZ-së KAS me shumicë votash vendosi:

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.03.2023*

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 33 të ankuesit "Partia Demokratike", përfaqësuar në seancë nga zoti Ledio Nuraj dhe zoti Franci Nuri.
2. Pranimin e pjesshëm të Kërkesës Ankimore nr. 32 të ankuesit "Partia Demokratike", përfaqësuar në seancë nga zoti Indrit Sefa dhe detyrimin e partisë "Partia Demokratike", të depozitojë në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë vijon:
 - Deklaratën sipas shkronjes "b" të pikës 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor me të dhënat për nënkryetarin, zoti Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;
 - "Deklaratën e angazhimit solemn" të nënshkruar nga nënkryetari zoti Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;
3. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor "Partia Demokratike" me nënkryetarin, zoti Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Apelit Administrativ Brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 27

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

